

## Hyrja në Zvicër

Hyrja në Zvicër është një broshurë që jep udhëzime të mjaftueshme për të huajt që dëshirojnë ta vizitojnë Zvicrën e në këtë rast kjo broshurë më së shumti i dedikohet shqiptarëve nga Kosova. Me anë të kësaj broshure ne jemi munduar që ti sjellim tek ju informacionet kryesore rreth rregullave të vëndosura nga qeveria zvicerane.

Informacionet në këtë broshurë janë të bazuara nga autoritetet zvicerane që mirrem me çështjet e të huajve duke përfshirë zyrën federale për migrim, autoritetet kantonale të migrimit dhe misionet diplomatike të Zvicrës.

### ➤ Rregullat e përgjithshme për hyrje dhe regjistrim

- Parakushtet për hyrje
- Arsyet dhe kohëzgjatja e qëndrimit
- Rregullat e regjistrimit

### ➤ Deklarata e sponsorizimit

- Tarifat
- Sigurimi i udhëtimit
- Ku dorëzohet deklarata e sponsorizimit?

### ➤ Procedurat

- Dokumente shtesë (të përcaktuara nga autoritetet përgjegjëse)
- Të drejtat ligjore

### ➤ Visat për banorët e Kosovës

- Viza kombëtare e tipit D (për kohë të gjatë, studime, punësim)
- Caktimi i terminit (intervistës) dhe aplikimi
- Tarifa e Vizës

### ➤ Burimet e materialeve



## Rregullat e përgjithshme për hyrje dhe regjistrim

Shtetasit e huaj që dëshirojnë të hyjnë në Zvicër duhet të respektojnë rregullat e hyrjes dhe doganës. Në çdo rast, ata duhet të jenë në posedim të një dokumenti të vlefshëm udhëtimit të njohur nga autoritetet zvicerane. Përveç kësaj, në raste të caktuara një vizë është e nevojshme dhe për këtë ne do bëjm një përshkrim të veçant se kush duhet të posedojn një vizë.

Informacionet zyrtare rreth hyrjes dhe vizave në Zvicër jepen nga Zyra Federale për Migrim (Bundesamt für Migration - BFM), përfaqësitë e jashtme të Zvicrës (ambasadat, konsullatat etj), dhe autoritetet kompetente të kantoneve. Ne duke u bazuar në punën e këtyre autoriteteve do sjellim tek ju informacionet e nevojshme në gjuhën shqipe. Nëse jeni duke planifikuar një udhëtim në Zvicër, apo jeni duke pritur një vizitë nga jashtë ose dëshironi të ftoni vizitorë nga jashtë, informacionet në vijim do jenë të nevojshme për të gjithë.

Që nga 12 dhjetori 2008 Zvicra është një shtet anëtar i marrëveshjes së Shengenit dhe kështu bën pjesë në zonën Shengen. Në bazë të rregullorës së Shengenit qytetarët që posedojn një vizë Shengen kanë të drejt të qëndrojnë në Zvicër deri në 390 ditë brenda 6 muajve pa u nënshtruar autoriteteve zvicerane .

Edhe personat të cilët marrin një vizë nga autoritetet zvicerane kanë të drejtë të qëndrojnë deri në 90 ditë brenda 6 muajve në të gjitha shtetet e zonës Shengen pa ju nënshtruar autoriteteve zyrtare të atij shteti.

### **Parakushtet për hyrje**

Siq thamë me herët shtetasit e huaj që dëshirojnë të hyjnë në Zvicër duhet të respektojnë rregullat e hyrjes dhe doganës. Në çdo rast, ata duhet të kenë në posedim një dokument të vlefshëm udhëtimi të njohur nga autoritetet zvicerane. Përveç kësaj, në raste të caktuara një vizë është e nevojshme dhe për këtë ne do bëjm një përshkrim të veçant se kush duhet të posedojn një vizë. Të gjithë vizitorët duhet të kenë një fond të mjaftueshëm të parave që i siguron mbulimin e shpenzimeve gjatë kalimit tranzit apo qëndrimit në Zvicër.

Informacionet zyrtare rreth hyrjes dhe vizave në Zvicër jepen nga Zyra Federale për Migrim (Bundesamt für Migration - BFM), përfaqësitë e jashtme të Zvicrës (ambasadat, konsullatat), dhe autoritetet kompetente të kantoneve. Ne duke u bazuar në punën e këtyre autoriteteve do sjellim tek ju informacionet e nevojshme në gjuhën shqipe.

### **Arsyeja dhe kohëzgjatja e qëndrimit**

Vizitorët e huaj që kanë hyrë në Zvicër në përputhje me rregulloret përkatëse dhe nuk ju është ofruar e drejtë punësimi nuk kanë të drejtë të punojn dhe nuk duhet kaluar kohën 3 mujore e cila parashihet në bazë të vizës. Për ata të cilët dëshirojnë të punojn në Zvicër janë të detyruar të aplikojn për lejë të punës.

Për më shumë informacione duhet kontaktuar autoritetet e migrimit të atij kantoni ku dëshiron të punoj.

### **Rregullat e regjistrimit**

Në bazë të rregullave të rrepta kushdo që ofron një strehim për shtetasit e huaj kundrejt një pagese është i detyruar të njoftojë menjëherë autoritetet kantonale. Nëse shtetasit e huaj janë të vendosur pa pagesë, nuk ka asnjë detyrim të njoftojë autoritetet. Shtetasit e huaj duhet të raportojnë menjëherë autoritetet komunale apo kantonale, nëse largimi i tyre brenda periudhës së qëndrimit të dhënë nuk është e mundur.

### **Deklarata e sponsorizimit**

Misionet e huaja zvicerane mund ta deklarojnë çështjen e një vize të mvarur në një deklaratë të sponsorizimit, nëse aplikuesi nuk ka qasje në fonde të mjaftueshme financiare ose nëse kjo duket e dyshimtë. Garantuesi angazhohet për ti përmbushur shpenzimet e pambuluara deri në CHF 30'000, për shpenzimet e jetesës, duke përfshirë aksidentet dhe sëmundjet, si dhe për udhëtimin e kthimit nëse këto janë të nevojshme përshkak të pranisë së huaj kombëtare. Nëse një deklaratë sponsorizimi është e domosdoshme, misioni zviceran do ti sigurojë vizitorit formularët e nevojshëm dhe udhëzimet.

Një deklaratë e miratuar e sponsorizimit nuk jep asnjë pretendim për çështjen e një vize.

### **Tarifat**

Përpunimi i një deklarate të sponsorizimit nga autoritetet kantonale bëhet kundrejt një tarife.

Si rregull, kjo tarifë administrative duhet të paguhet paraprakisht (më shumë informata merreni tek autoritetet kantonale).

### **Sigurimi i udhëtimit**

Pavarësisht nëse kërkesa e dorëzuar mund të refuzohet, autoritetet kompetente të kërkojnë një sigurim të udhëtimit. Mbulimi minimal i sigurimit të është i barabartë me 30'000 Euro.

### **Ku dorëzohet deklarata e sponsorizimit?**

Garantuesi duhet të dorëzojë deklaratën e sponsorizimit te autoritetet komunale të migrimit, nëse jeton në njërin nga këto kantone: Aargau, Basel-Land, Bern, Freiburg, Graubunden, Schwyz, St. Gallen, Thurgau, Uri, Valais, Vaud, Zurich ndërsa për kantonet tjera duhet dërguar tek autoritetet kantonale të migrimit.

Në përshtetë kemi përmbledhur të gjitha adresat e zyrave të migrimit në bazë të kantoneve. Nëpër këto zyra mund të merreni informacione nga të gjitha fushat rreth çështjeve për të huaj.

**AG****Amt für Migration und Integration**

Bahnhofstrasse 86/88

5001 Aarau

Tel.: 062 835 18 60

Fax: 062 835 18 38

[migrationsamt@ag.ch](mailto:migrationsamt@ag.ch)**AR****Migrationsamt**

Landsgemeindeplatz 5

9043 Trogen

Tel.: 071 343 63 33

Fax: 071 343 63 39

[migrationsamt@ar.ch](mailto:migrationsamt@ar.ch)**AI****Amt für Ausländerfragen**

Marktgasse 2

9050 Appenzell

Tel.: 071 788 95 21

Fax: 071 788 95 29

[thomas.rickenbacher@jpmid.ai.ch](mailto:thomas.rickenbacher@jpmid.ai.ch)**BL****Amt für Migration**

Parkstrasse 3

4402 Frenkendorf

Tel.: 061 552 51 61

Fax: 061 921 04 24

[afm@bl.ch](mailto:afm@bl.ch)**BS****Migrationsamt**

Spiegelgasse 12

Postfach

4001 Basel

Tel. 061 267 70 70

Fax 061 267 78 30

[migrationsamt@jsd.bs.ch](mailto:migrationsamt@jsd.bs.ch)**BE****Migrationsdienst des Kantons Bern**

Kundenzentrum

Eigerstrasse 73

3011 Bern

Tel.: 031 633 53 15

Fax: 031 633 42 40

[midi.info@pom.be.ch](mailto:midi.info@pom.be.ch)**FR****Service de la population et des migrants**

Rte d'Englisberg 11

1763 Granges-Paccot

Tel.: 026 305 14 92

Fax. 026 466 17 85

**GE****Office cantonal de la population****Service des Etrangers et des Confédérés**

Route de Chancy 88

1213 Onex

Tel.: 022 546 48 88

Fax: 022 546 48 10

[ssie.ocp@etat.ge.ch](mailto:ssie.ocp@etat.ge.ch)**GL****Fachstelle für Migration**

Postgasse 29

8750 Glarus

Telefon: 055 646 68 90

Fax: 055 646 68 91

[migration@gl.ch](mailto:migration@gl.ch)**GR****Amt für Polizeiwesen und Zivilrecht**

Karlihof 4

7001 Chur

Tel. +41 81 257 30 01

Fax +41 81 257 21 46

[info@apz.gr.ch](mailto:info@apz.gr.ch)**JU****Service de la population**

1, Rue du 24-Septembre

2800 Delémont

Tel.: 032 420 56 80

Fax: 032 420 56 81

[secre.spop@jura.ch](mailto:secre.spop@jura.ch)**LU****Amt für Migration**

des Kantons Luzern

Fruttstrasse 15

6002 Luzern

Tel.: 041 228 77 82

Fax: 041 210 01 39

[migration@lu.ch](mailto:migration@lu.ch)

**NE****Service des migrations (SMIG)**

Rue de Tivoli 28  
2003 Neuchâtel  
Tel.: 032 889 63 10  
Fax: 032 889 98 23

**NW****Amt für Migration**

Kreuzstrasse 2  
6371 Stans  
Tel. 041 618 44 90/91  
Fax: 041 618 44 87  
[migration@nw.ch](mailto:migration@nw.ch)

**OW****Amt für Justiz**

St. Antonistrasse 4  
6061 Sarnen  
Tel. 041 666 66 70  
Fax: 041 666 66 75  
[migration@ow.ch](mailto:migration@ow.ch)

**SO****Migration und Schweizer Ausweise**

Ambassadorenhof  
4509 Solothurn  
Tel.: 032 627 28 37  
Tax: 032 627 22 67

**SG****Migrationsamt**

St.Leonhard-Strasse 40  
9001 St. Gallen  
Tel.: 058 229 31 11  
Fax: 058 229 46 08

**SH****Migrationsamt und Passbüro**

Mühlentalstrasse 105  
8200 Schaffhausen  
Tel. 052 632 74 76  
Fax: 52 632 78 23  
[migrationsamt@ktsh.ch](mailto:migrationsamt@ktsh.ch)

**SZ****Amt für Migration**

Steistegstrasse 13  
Postfach 454  
6431 Schwyz  
Tel.: 041 819 22 68  
Fax: 041 819 22 79

**TI****Sezione della popolazione**

Via Lugano 4  
6500 Bellinzona  
Tel.: 091 814 72 11  
Fax: 091 814 72 19  
[di-sp@ti.ch](mailto:di-sp@ti.ch)

**TG****Migrationsamt**

Schlossmühlestrasse 7  
8510 Frauenfeld  
Tel.: 052 724 15 55  
Fax: 052 724 15 56  
[migrationsamt@tg.ch](mailto:migrationsamt@tg.ch)

**UR****Amt für Migration**

Klausenstrasse 4  
6460 Altdorf  
Tel.: 041 875 27 05  
Fax: 041 875 27 92  
[arbeit.migration@ur.ch](mailto:arbeit.migration@ur.ch)

**VS****Service de la population et des migrations**

Avenue de la Gare 39  
1950 Sion  
Tel.: 027 606 55 52  
Fax: 027 606 55 54  
[spm@admin.vs.ch](mailto:spm@admin.vs.ch)

**VD****Service de la population Secteur Etrangers**

Avenue de Beaulieu 19  
1014 Lausanne  
Tel.: 021 316 46 46  
Fax: 021 316 46 45  
[info.entrangers@vd.ch](mailto:info.entrangers@vd.ch)

**ZG****Amt für Migration (AFM)**

Aabachstrasse 1  
Postfach 857  
6301 Zug  
Tel.: 041 728 50 50  
Fax: 041 728 50 59

**ZH****Migrationsamt**

Berninastrasse 45  
Postfach  
8090 Zürich  
Tel.: 043 259 88 00  
Fax: 043 259 88 10  
[info@ma.zh.ch](mailto:info@ma.zh.ch)

## Procedurat

1. Individët që kërkojnë një vizë janë të detyruar të paraqesin kërkesën e tyre tek misioni i jashtëm zviceran në vendin e tyre të banimit. Formulari i aplikimit jipet falas nga misionet e huaja zvicerane. Formulari i aplikimit duhet të dorëzohet së bashku me dokumentin e udhëtimit, si dhe sipas kërkesës, dokumente të tjera që vërtetojnë arsyen e udhëtimit
2. Nëse misioni i huaj kërkon një deklaratë sponsorizimi, vizitorët duhet plotësuar një formularë dhe paraqesë tek garantuesi
3. Garantuesi plotëson dhe nënshkruan deklaratën e sponsorimit dhe së bashku me të gjitha dokumentet tjera të nevojshme duhet dërguar tek autoritetet komunale apo kantonale
4. Deklarata e sponsorizimit kontrollohet nga autoritetet komunale apo kantonale dhe futet në qendrën e sistemit të informimit për migrim
5. Rezultati i këtyre konsideratave menjëherë komunikohet tek misioni i jashtëm të cilët pastaj vendosin në lëshimin e vizës

### *Dokumente shtesë (të përcaktuara nga autoritetet përgjegjëse)*

- Dokument identifikimi (pashaportë, letërnjoftim, lejëqëndrim të huaj)
- Prova të aftësisë paguese (deklarata nga llogaria bankare, deklarata të rrogave, deklarata tatimore apo zbatohen të dhënat nga pagesat e regjistruara)
- Tjera

### *Të drejtat ligjore*

Në rastin e një refuzimi të vizës, përfaqësimi i jashtëm zviceran komunikon vendimin të aplikuesi në emër të Zyrës Federale për Migrim (Bundesamt für Migration - BFM) duke përdorur rregullat ligjore. Aplikuesi mund të ankohe me shkrim kundër këtij vendimi të Zyra Federale për Migrim në Bern, brenda 30 dite nga data e publikimit të refuzimit.

Për këtë çështje të kontestueshme BFM lëshon një vendim me një tarifë ku aplikuesi mund të ankohe në Gjykatën Federale Administrative në Bern, brenda 30 dite nga vendimi. Nuk ka të drejtë të pavarur të apelit kundër një deklarate negative të autoriteteve kantonale ose vendore.

## Visat për banorët e Kosovës

### *Viza Shengen*

Një vizë Shengen ju lejon të qëndrojnë në Zvicër deri në 90 ditë brenda një periudhe 6 mujore.

Ajo mbulon vizita si turist, për të vizituar miqtë dhe familjen, takime biznesi, studime (deri në 90 ditë) dhe vizita për arsye shëndetësore. Një vizë Shengen nuk ju lejon të punoni, pa marrë parasysh nëse puna është paguar apo jo.

### *Viza kombëtare e tipit D (për kohë të gjatë, studime, punësim)*

Qëndrimi në Zvicër kërkon një vizë zvicerane të tipit D. Kjo vizë nevojitet nëse dëshironi të ribashkohuni familjës tuaj në Zvicër (fëmijët, bashkëshorti/-ja), të punoni në Zvicër apo nëse planifikoni të qëndroni gjatë në Zvicër.

Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen në Qendrën Rajonale Konsullore për Ballkanin Perëndimor e cila gjendet në Prishtinë pra Ambadada e Zvicrës. Për të paraqitur një aplikim për vizë, së pari ju duhet të bëni një takim. Pasi që procesi mund të zgjasë 8-16 javë nga fillimi deri në fund, ju lutemi bëni aplikimin tuaj në fillim.

### ***Caktimi i terminit (intervistës) dhe aplikimi***

Për të bërë një takim, ju duhet të vini personalisht në ambasadë dhe është e nevojshme të merreni me vete edhe pasaportën tuaj. Ju do të merrni një fletë informacioni që do të shpjegojë se cilat dokumente ju duhet të sillni me vete në ditën e takimit tuaj. Nuk është e mundur për të bërë një takim me telefon ose e-mail. Për caktimin e takimit nuk keni nevojë të paguani tarifë. Kohën e takimit mund ta bëni çdo ditë pune He-Pr prej 13.30 – 16.30.

Të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe të smurët mund të përfaqësohen nga një anëtar i familjës, i cili duhet të ketë me vete një autorizim nga notari apo avokati dhe pasaportën e personit që e përfaqëson. Ju lutem keni parasysh se caktimi i kohës për termin si dhe termini që do të caktohet mund të zgjasë prej 5 deri 20 ditë pune. Nuk është e mundur për të organizuar një takim më parë, ose që të korrigjohet një takim me e-mail, telefon, apo faks.

Qendra konsullore nuk do të pranojë kërkesën tuaj nëse arrini me vonë apo nuk keni të gjitha dokumentet e nevojshme. Nëse ndodh kështu atëherë ju duhet të bëni një takim të ri prandaj keni parasysh të gjitha dokumentet e nevojshme para takimit dhe mos u vononi.

Ju do të njoftoheni lidhur me vendimin e autoriteteve kantonale të migrimit disa javë pas intervistës tuaj. Kur të vini me tërheqje vizën ju lutem sigurohuni të merreni me vete vendimin (shtypur në letër apo e-mail) si dhe pasaportën tuaj.

Koha për tërheqjen e vizave është çdo ditë pune He-Pr prej orës 8 – 10.

Formularin për aplikim (Shqip – Gjermanisht) mund ta mirreni në sportelin e ambasadës apo ta shkarkoni nga interneti: [www.bfm.admin.ch/content/dam/data/migration/einreise/visumantragsformulare/visumantrag-visumd-sq-de.pdf](http://www.bfm.admin.ch/content/dam/data/migration/einreise/visumantragsformulare/visumantrag-visumd-sq-de.pdf)

### ***Tarifa e Vizës***

Tarifa e vizës duhet paguar në sportelin e ambasadës kur ta bëni aplikimin dhe çmimet janë:

- Për të rritur 60,00 €
- Fëmijët e moshës 6 – 12 , 35,00 €
- Fëmijët nën moshën 6 vjeqare, falas
- Fëmijët dhe bashkëshortët e qytetarëve të Zvicrës, vendeve të BE-së dhe zonës EFTA janë falas.

Ju lutem të keni parasysh se paratë e tarifave nuk kthehen nëse viza juaj është refuzuar.

### **Burimet e materialeve**

Të gjitha këto burime janë të bazuara nga

Zyra Federale për Migrim  
Bundesamt für Migration – BFM  
[www.bfm.admin.ch](http://www.bfm.admin.ch)

Departamenti Federal i Punëve të Jashtme  
Eidgenössisches Departement für auswärtige Angelegenheiten (EDA)  
[www.eda.admin.ch](http://www.eda.admin.ch)

**Përshtati:**  
**Faton Krasniqi**